
POSTIM ARKIVOR

Gjyqi Special i vitit 1945

Gjyqi Special i Tiranës dhe ndëshkimi i kundërshtarëve të regjimit komunist



SEKSIONI

1944-1950

PERIUDHA

1945 - 1943

Është një nga proceset e para gjyqësore që çoi në ekzekutimin dhe dënimin me shumë vite burg të personaliteteve që dyshoheshin si kundërshtarë të sistemit komunist. Ky proces, i quajtur Gjyqi Special i Tiranës, zhvilloi 31 seanca nga 1 marsi deri më 13 prill 1945, duke gjykuar 60 nacionalistë të akuzuar si kriminelë lufte: 17 prej tyre u dënuan me pushkatim, 8 me burgim të përjetshëm dhe të tjerët me dënime të ndryshme me burg.

PERMBAJTJE #1


Lista e 37 të pandehurve dhe mbrojtja e Beqir Valterit në dosjet e vitit 1945

Arkivi i Sigurimit administron dosjet gjyqësore Nr. 12551.1 (1568) dhe Nr. 1255-1 +1568 të vitit 1945, që lidhen me procesin ndaj Fejzi Alizotit, Terenc Toçit, Aqif Përmetit dhe të tjerëve. Këto dosje përmbajnë materiale në gjuhën frënge dhe italiane, deklarata me shkrim dore, procesverbale dhe raporte hetimore për një numër të madh të pandehurish, të akuzuar për bashkëpunim me pushtuesit dhe veprimtari antikomuniste. Një document tjetër I përzgjedhur nga dosjet përfshin edhe listën e 37 personave që do të kalonin të parët në gjyq, një faqe e marrë nga dosja gjyqësore Nr. 12551.1 me titull “Fejzi Alizoti, Aqif Permeti etj.”. Publikimi i këtij materiali synon të sjellë në vëmendje një burim me vlerë historike, që ndihmon në kuptimin e rolit, qëndrimeve dhe mbrojtjes së tij përpara gjykatës. Në platformë publikohet këtë herë dokumenti i mbrojtjes së Beqir Valterit, një figurë e përfshirë në ngjarje të rëndësishme historike të Shqipërisë. Më 23 shkurt 1924, ai kreu një atentat ndaj kryeministrit Ahmet Zogu brenda Kuvendit, duke e plagosur lehtë me dy plumba; më pas u arrestua, por u lirua nga qeveria e Fan Nolit, vendim që shkaktoi reagime të forta. Në vijim, gjatë pushtimit italian dhe gjerman, Valteri mbajti poste të larta, ndërsa në vitin 1945 u dënua me pushkatim në Gjyqin Special si “kriminel lufte”

MEDIA #1

Lista e 37 personave që do të kalonin në gjyq të parët

MEDIA FAQE #1



Lista e 37 personave që do të kalonin në gjyq të parët

INFORMACION

Lista e 37 personave që do të kalonin në gjyq të parët

FONDI	Hetimor-Gjyqësor


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #1



TRUPIT GJYKUES TË FRONTIT NACIONAL ÇLIRIMTAR

Zotnij Gjykatës,

Kur hynë në Tiranë fuqit e Nacional Çlirimtarës unë u mëshefa dhe hika.Hika nga frika se mos më mbytte uji i turbullt!

Mbas dy javë që u qetësue pak gjendja dhe u proklamue amnistija për fajet politike,erdha me kambët e mija tue i u shtrue pusntetit të Nacional Çlirimtarës.E,të më besoni se kam ardhë jo pse edhe unë s'kam muejt me qindrue si i aratisun,por pse më pëlqeu fryma dhe programi i Frontit.

Tash që ju kallzova sinqerisht arsyen e dorëzimit t'em,që dhe gjustifikimi i jem për të shkuemen e pesë vjetve të periodës së okupacjoneve.

x x x

Zotnij Gjykatës,pa dyshim Nacional Çlirimtarja ka të drejtë me rolë e m'e drejtue këtë Vend si nji Front që pesë vjetë rrjeshtë ka pësue lloj lloj pësime e vuejtje tue luftue kundra okupatorve.Sakrificat e Nacional Çlirimtarve shqiptarë i kanë tregue botës mbarë se shqiptari asht nji racë e fortë dhe nji popull që me çdo kusht don lirì dhe të drejtat e veta.

Nacional Çlirimtarët janë djelmët ma të mirë të popullit shqiptarë. Disiplina si edhe sakrificat e bane nga ana e djelmëvet dhe vajzavet të Nacional Çlirimtarës në luftën kundra okupatorve,kanë me mbetë veprime legjendare;vetëm,dhe të gjithë ata që ndejten indiferent ose kanë bashkëpunue me okupatorët,nuk mund të konsiderohen djelmë të këqij të këtij vendi e aq ma pakë nuk mund të quhen trathtorë.Së paku kështu mendoj për vedi e që përse:

IDET DHE VEPRIMET E MIJA POLITIKE

Zotnij Gjykatës,që të mund të ju përgjigjem akuzave që më bani,më duhet që shkurtimisht të ju njoftoj pak idét dhe veprimet e mija tue filiue që nga mosha e rëmijnis.

Kur kam qenë edhe fare i vogël,unë kam ndi nji dashuni atdheu dhe gjithnji kam veprue me sa kam muejtë.


Në moshen gjashtë vjeçë,im atë,ndonse nji malësor i thjeshtë,i etshem për kulturë më pat çue në shkollat turke në Stambollë.

Me 1919,në mbarimin e Luftës së Madhe,tue dëshirue me i vazhdue mësimet në gjuhen shqipe,hika prej shkollave turke dhe ktheva n'Atdhé.

Me 1920,tue qenë endé nji rëmi 19 vjeçarë,me entusiazëm të madh jam

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #2



- 2 -

ba antarë i nji shoqnije patriotike që kish themelue Avni Rustemi në San-Dimetrio-Corene t'Italls.Po në fund të këtij moti,Lidhja Patriotike e studentave shqiptarë të Komës që qahej Shoqnija Shpresa,më ngarkoi përfaqësues të saje në Shqipni për me mbledhë ndihma.Letër përfaqësimin e ka pasë firmue sekretari i Shoqnls Vasil Ziu,sot Kryetar i Frontit Nacional Çlirimtar të Durrësit.

Me 1921,me sygjerimin t'em që i pata ba Vasil Bidoshit,asht formue në Napoli shoqnija patriotike e Studentave Shqiptarë "NAIM FRASHERI".

Me 1922,drejtë për së drejti,prej inisjativës s'eme,asht formue në qytetin Lecce (Itali) nji shoqni tjetër nën emnin "ISMAJL QEMALI".Ket mund të m'a vertetojnë shokët e kolegjit si Dr.Remzi Kico,Abaz Omari,Namik Cakrani,Stefan Shundi etj.

Me 1923,po prej inisjativës s'eme,asht formue në Korçë nji shoqni tjetër nën emnin "YLLI I MENGJESIT".Kjo shoqni përbahej prej nxansave të krahinave të ndryshme të Shqipnis që kishin ardhë në Liceun e Korçës.Por, ma vonë,mbas disa muejve,për mos me qenë të ndamë prej rinls korçare,me bashkëpunimin e disa shokve korçarë,formuem nji shoqnl të përbashkët nën emnin "SHPRESA".Kjo shoqnl ka pasë nxierrë edhe nji organ të përmuejshëm e,dhe unë kam qenë nji nga redaktorët e sajë.Artikujt e mij edhe sot mund të gjinden në Biblioteken Kombëtare:Revista Shpresa Nr.1 e 2. dhe aktivitetin t'em përgjithësisht mund të m'a vertetojnë të gjithë shoket e Liceut si:Aleko Tashko,Dr.Sinan Imami,Petraq Pepo etj.etj.


Po në vitin 1923,gjithnji me entusiazëm të madh për me i shërbye sa ma shumë çeshtjes kombëtare,tue pa trathëtit e krimet e Ahmet Zogut si edhe mënin e popullit kundra tij,unë pata guxue për me atentue jetën e trathëtorit tue dalë në shesh vullnetarisht.Këtë ngjarje e vërteton vet historija e Shqipnis së Re dhe mbassi fati i keq më solli që të gjykohem sot para jush si "trathëtor"! tash më duhet pak edhe me u levdue:

Veprën e kryva në mënyrën që i bante nderë djelmënls shqiptare.I dhash tiranit tri plagë revolveri kur ay ish diktator fuqiplotë i vendit dhe i rrethuem me dyzina cuba t'armatosun.Kam edhe ma:

Kur i dola para tiranit për me i ra e për me e shtri,gjoksin t'em e pata mbështjellë me nji flamur kombëtar.E,mbrapa me mbrojtjen që bana për ma se nji orë kundra cubave të tij që shtijshin pa pra kundra meje,plumbat e tyne i prita me pushkë e kangë kombëtare në gojë.

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #3



- 3 -

Në krismat e pushkave pata këndue at kangën e Hilë Mosit:"Atje n'at vend të lamun,me gjak arbnorit t'lirë"...Ket mënyrë veprimi,në mes shum të tjerve mund të ja u vertetoj dhe ish shoku i jem - e sot vetëm i jueji - Sejfulla Maleshova i cili ka ndodhë në Parlament kur u ba ngjarja dhe u burgos së bashku me mue.

Mbas disa muejve burg të randë me tortura e mandej mbas gjashtë muej lirije dhe aklamacjoni nën qeverln revolucjonare të Fan Nolit,ne mes qindra intelektualësh që morën rrugën e ekzilit tue hikë nga ardhja e Zogut në fuqi,natyrisht qesh edhe unë.

JETA E JEME N'EKZIL

Dhe n'ekzil,ndonse isha fare i rl e kam qenë gjithnji i përsekutuem prej agjentave të Zogut,nuk mbeta pa veprue:

Me anën e nji grupi të vogël që pata formue në Paris nën emnin:BASHKIMI I DJELMËNIS",kam luftue rrebtas tiranin e Zogut dhe penetracjonin italjan në Shqipnl tue i drejtue Lidhjes së Kombeve e Kancelerive memorandume e telegrame protestimi.E kam pasë çveshë Ahmet Zogun përpara opinjonit europjan e i kam luftue të gjitha lidhjet që pat ba Roma me Qeverin e Zogut. Ket shoqni e pata formue me disa studentë,puntorë e ish-oficera të hikun dhe,aktivitetin t'em mund të m'a vertetojnë të gjithë shqiptarët që janë ndodhun në Paris.

Mbas shumë veprimeve të ndryshme në fushen kombëtare,ma në fund tue pa se Italija dita më ditë po pënetronte në Shqipnl e,tue kuptue se Shqipnija nuk mund të shpëtonte vetëm me fuqit e veta,përqafova idén e bashkimit të popujve të ballkanit në gjinin e nji Konfederate.


Nji bashkim ballkanik,si tash edhe asi kohe,e favorizonte Rusija Sovjetike.Por,unë,tue kuptue se,nga frika e komunizmës çdo idé që dilte nga Moska gjente kundërshtimin e të gjith oksidentit,këtë idé të naltë,mendova t'i a paraqes botës m'aspektin thjeshtësisht kombëtar e të pamvarun nga Moska.

- Nga ana tjetër nuk mund të mohojë edhe se,unë si nacjonalist,edhe vet isha e jam i parimit që idéja e nji bashkimit ballkanik të dalë si nji vullnet i popujve të Ballkanit tue mos u drejtue Ballkani nga asnji fuql e madhe.

Sikundër e kam çraqë mendimin t'em dhe në fletoren "BASHKIMI I KOMBIT" me 3 dhjetor 1943,Konfederaten Ballkanike e kam andrrue dhe e kërkoj

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #4



- 4 -

113 (29

në mënyrë që seicili popull të rregullohet me frymen,karakteristikat dhe vlerat e veta dhe,popujt e Ballkanit,si shtete të bashkueme,në politiken rivale të fuqìve të mëdhà të mbeten të pa-anshëm për me e ba vendin e tyne një faktor paqeje n'Europë dhe në botë.Me këtë frymë e drejtim kam themelue edhe një grup të vogël nën emnin "PARTIJA NACIONAL-BALLKANIKE SHQIPTARE",të cilin muejta me e shpallë botnisht ndër ditet e fundit që ishte tue u largue ushtrija gjermane nga Shqipnija.—

Me gjithë se mendimi i jem ka qenë ky,ma vonë,tue kuptue se rrealizimi i shpejtë i kësaj idéje,ka nevojë për ndihmen e një shteti të madh,për të parën herë drejtova një "memorandum" prezidentit Hoover tue kërkue ndihmen e Shteteve të Bashkueme t'Amerikës.Bashkë me memorandumin pata çue edhe një flamur që pata sajue për konfederatën.


Ndonse mizerja e mergimit më kish randue e turbullue tepër - pse nga mos-pasja,vuejsha edhe për bukë e shpesh herë flija nën ura - po për idén e bashkimit ballkanik i kam pasë drejtue edhe një memorandum Konferencës së parë për afrimin ballkanik që u mbledhë n'Athinë me 1931,tue i kallxue asaj konditat mbi të cilat mund të realizohej idéja e bashkimit ballkanik. Këtë memorandum e pata botue edhe në formë manifeste tue harxhue paret e qërasë së hotelit dhe si konseguencë të kësaj vepre pata mbetë dhe pa odë tue u shtrengue me fjetë prap nën ura e disa herë n'odën e ndonji shoku. - Ju njoftoj edhe se,ndër të hikunit ,jam i vetmi që s'kam pasë marrë rrogë nga ndonji shtet i huej dhe kam jetue gjithnji tue i lypë shokve e miqve personal.Dikuj i kam marrë pare për me mangër një copë bukë,dikuj tesha me u veshë e dikuj këpucë për me u mbathë e,ndonse kamen e kamë të numurit 41,të gjitha numurat prej 39 e naltë i pranonja...

Jeta e jeme në Paris ka qenë e tmerëshme.Për dhjetë vjetë rrjeshtë e kam ba vet bukën,i kam la vet enët,i kam la vet teshat e çdo natë flinja me frigë se a do të kisha për me mangër ne të nesërmen,pse shpesh herë më ka qillue me mbetë rare pa te.Dhe,kjo mizerje m'asht shkaktue jo pse edhe une s'mund të mirrsha ndonji rrogë prej ndonji qeverije,por pse kisha vendosë me luftue fqijtë që paguejshin për arsyenat e tyne politike.Lufta e jeme kundra fqijve imperialist,ka qenë aq intransigjente sa që qesatjen e lirimit të Kosovës dhe nevojën e një Konfederate ballkanike,e kam pasë çraqë bashkë në Jugosllavìn vet dhe si konseguencë të këtij gjesti,autoritetet jugosllave të Sushakut më patën ekspulsue.Kjo më 1927.

ARBSH
NGRSH

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #5



- 5 -

114 (30

Prej Jugosllavije shkova në Vjenë por mjerisht edhe prej andej për intrigat e konsullit të Zogut Çatin Saraçit u ekspulsova e menjiherë, mbas shum mundimesh,u nisa për në Francë ku qindrova deri me 1939.

Ket jetë aktiviteti,persekutimi e mizerje mund të m'a vertetojnë të gjithë të hikunit si dhe studentat e puntorët shqiptarë që ndodheshin në Paris.

EDHE NJI TJETËR VEPËR QË ME NDERON:

Tue mos gjetë asnji mbështetje të pa komprometueshme për levizjen t'eme shqiptare e ballkanike grupi u shpërnda,e,si person,inspirue me ndjenja njerzore e paqësore,tue pa padrejtësin e fuqive të mëdhà imperialiste si dhe pazotesin e Lidhjës së Kombeve për mbrojtjen e të drejtave të seicilit popull,më ra ndër mend nji idé e më

Për me i dhanë nji fuqì Lidhjes se Kombeve d;M;th.për mos me e lanë Institutin e Gjeneveës vetëm ndër duert e Fuqive të Mëdhà e pash të dobishme që të gjithë popujt e vegjël të botës të lidhen në nji institucjon të veçantë tue u organizue ata ma parë në konfederata.Për realizimin e kësaj idéje i drejtova nji memorandum qeverìs holandeze tue i sugjerue asaj mendimin që ajo si nji shtet i respektuem në botë të merrte inisjativen për realizimin e këtij projekti.Dhe kjo idé e jeme e organizimit të popujve të vegjel në nji institucjon të veçantë asht e njoftun prej shokve të mergimit pse dhe këte,tue e lanë vedin keq,e kam pasë shtypë dhe shpërndà ndër broshura,ku sa dij unë,nji kopje të këtij projekti,gjindet ndër dokumentat që më kenì marrë.Mbassi qeverija holandeze nuk më dha nji përgjigje të favorshme,projektin t'em për bashkimin e popujve të vegjël i a pata dërgue edhe qeverìs republikane të Spanjës.

Ket mendimin t'em,për lidhjen e popujve të vegjel,në nji institucjon të veçantë - tue u organizue ata ma parë në konfederata të veçanta - asi kohe e patën marrë me tallje,por sot kjo idé asht tue u mprojtë edhe prej personaliteteve politike përgjegjëse.Disa muej ma parë,kam këndue në nji fletore ku zoti Smuts-i,prezident i Afrikës Jugore e mpronte me nxehtësì këtë mendim.

x x x


TË VIJMË TASH TEK ÇESHTJA QË JU INTERESON JUVE:

Tue notue unë në Paris me këto idéna të bukura e bujare që ju çraqa,

ARBSH
NGRSH

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #6



- 6 -

115 / 31

nji fatkeqësi kombëtare i a mërrijti Atdheut t'onë:Italija okupoi Shqipnin! Nga kjo ngjarje,si për çdo shqiptar të mirë,më nji grusht i randë,e i randë fort.

Në këtë kohë fatzeze për Shqipnìn,agjentet italjan të Paris-it,tue na premtue lirì,Shqipnì të madhe e ku di unë,na ftonin me u këtnye në Shqipnì! Thirrje e tmerëshme!Na që kishim hikë,na që kishim ndejtë 15 vjet jashta Atdheut kundra nji tiranije të mbrendëshme,tash na kërkonin për me i u shtrue nji okupatori të huej...

Se çfarë lirije e Shqipnije të madhe mund të kishim me Italìn unë e kuptojsha,dhe e kuptojsha mirë.Por,tue kuptue edhe se çeshtja shqiptare nuk zgjidhej ma vetëm me opozicjonin t'onë që mund të bajshim na tue mbetë jashtë,si dhe për mos me e vazhdue edhe mergimin e të mbetësha si nji i huej për Shqipnìn - pse nji kalà mund të merret ma lehtë së mbrendëshmi - pranova për me u këtnye n'Atdhé.

POZITA E JEMË NËN OKUPACJONIN ITALJAN

Zotnij Gjykatës,thash se kalaja mund të merret ma lehtë së mbrendëshmi.Me këtë frazë deshta me thanë,unë u ktheva n'Atdhe dhe me nji qellim:

Për me mundë nji sundues ka rruga të ndryshme dhe mbas mendimit t'em, kurr s'ke fuqì armësh të mjaftë për me luftue,ke rrugen e adoptimit.Due me thanë:unë kam qenë i mendimit për me fitue besimin e okupatorit,me shpetue me të mirë nga thojtë e tij aq sa mundet,m'u armatosë e me u organizue me mjetet e tija e ma në fund në momentin e dobët të tij me i ra kokës.

Tue pasë vendosë pra me hecë kësaj rruge kam rrezikue me të tue rolë e shkrue ndonji herë si në favor të tij.

Okupacjonin e pash t'arsyeshme që të mos luftonet per deri sa të vije momenti i volitshëm dhe për nji arsye tjetër:mbassi në luftën që piasi, Kosova u këtnye me Shqipnìn,qortë edhe nën okupacjonin e tanë Shqipnija, ish nji dobì e madhe për avenirin e Kombit t'onë që të gjithë shqiptarët të bashkëjetojnë për nji kohë nën nji regjim,tue u njortë e tue komunikue midis tyne.


Cilën kohë kam pritë unë për me luftue me armë kundra armikut okupator?

Me sa kam muejt me gjykue unë,kjo luftë botnore që po zhvillohet, asht shkaktue e vazhdon të banet vetëm e vetëm për interesat politike e ekonomike të fuqive të mëdha,dhe,tue qenë kështu,popujt e vegjel s'kan

AIDSSH

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #7



- 7 -

116 / 32

aspak interesë me u ba me njenën apo me tjetrën anë.

Mbas mendimit t'em,popujt e vegjël,zanin e tyne duhet t'a qesin vetëm në mbarimin e luftës d.m.th.kur fuqìt e mëdha të lodhen nga lufta e tyne të shtrohen në tavolinen e paqës.

Shpesh herë i kam pasë thanë shokve e miqvet:të rrijmë urtë që të mund t'i pregaditemi së nesërmes,pse sot që po vriten miljona e miljona njerëz nga të gjitha anët e botës,sikur njiqind mij shqiptarë me derdhë gjakun e tyne kundra okupacjonit asht sikur me hjedhë nji kovë ujë n'Oqeanin Atdhantik - kurse nesër kur të ket pushue lufta me u vra edhe njiqind shqiptarë për të drejtat t'ona,kishim me tërhjekë vërejtjen dhe aprovimin e të gjithë botës së qytetnurme në favorin t'onë.Kam pasë thanë edhe:asht e vërtetë se lufta po bahet për interesat politike e ekonomike ,por nesër, nuk mund të bahet nji paqe pa marrë parasysh edhe vullnetin e popujve që asht për drejtësi.

NJI TENTATIVË PËR TË CILËN MERITOJ LAVDATA

Posa erdha prej egzili,tue konstatue se rreziku ma i madh që mund të na vinte prej Italìs ishte kolonizimi i Shqipnìs,i kam drejtue Qeverìs nji kërkesë tue çfaqë nevojën e krijimit të nji drejtorije për organizimin e shqiptarve të jashtëm.N'at kërkesë i gjithë qellimi i jem ka qenë: në vend të ~~kolëre~~ kolere italjan që mendonej se do të vinin,t'instatloheshin shqiptarët e jashtëm.Por,mjerisht,me gjithë lajkat që bana nuk pata sukses në këtë tentativë.Kopjen e kësaj kërkese e keni ndër dokumentat që më keni marrë.

Edhe nji tentativë tjetër:

Mbassi nuk më dolì organizimi i shqiptarve të jashtëm,e tue pa se ajo "Partija Fashiste Shqiptare" drejtue prej Giovanni Giro-s po na e xhveshte djelmënìn nga idénat shqiptare,kërkova formimin e nji partije të ré nacjonale nën emnin "ROJA KOMBËTARE".


Me këtë tentativë - natyrisht tue mos i u largue parimeve fashiste e tue u angazhue me luftue doktrinën komuniste - kërkova me ruejtë individualitetin shqiptar tue i hjekë të gjitha amblemat dhe gjuhen italjane nga perdorimi,pse siç e dini,n'at kohë nji shumicë e madhe e popullit u shkrue në Partin Fashiste dhe deri ndër shkolla e formacjone djelmënije kishin fillue me u xxxk dhanë komandat në gjuhen italishte.

Tue konstatue edhe se,nji ditë do të përlesheshim me italjanët e tue

AIDSSH

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #8



- 8 -

pa se ushtrija shqiptare bani fuzjon me ate t'Italis,pata kërkue dhe formimin e nji Milicije shqiptare të formueme e të komandueme krejtësisht prej shqiptarve tue caktue detyren e sajë për me ruejtë kufijt e Shqipnis.

Këtë partì "ROJA KOMBËTARE" mendonja me e këthye ma vonë në nji rrymë ballkanike ashtu si e çpalla me hikjen e gjermanve: Partija NACIONAL-BALLKANIKE Shqiptare - programin e së cilës besoj se e keni lexue.

Kërkesën për me formue këtë Partì i a pata paraqitë inspektorit të Partis Giovanni Giro-s,por m'a refuzoi tue i konsiderue idét e mija separatiste.

I zemruem me Giovanni Giro-n për mos përkrahjen e kësaj kërkese,pata tentue - po për këtë qellim - edhe me pas-ardhësin e tij Piero Parinin.Këtij i pata ba edhe nji telegram urimi kur u bë inspektor i partis.Teksti i këtij telegrami që asht botue në fletoren "FASHIZMI" e tregon qellimin t'em.

Në projektin t'em,edhe me Parinin s'pata sukses dhe që prej asaj kohe kam qindrue larg partis fashiste.Me gjithse tri herë rrjeshtë me shkrim më ka thirrë partija për me u betue si antar,unë nuk jam paraqitë.Këta dokumenta mund t'i gjeni ndër letrat që m'i keni marrë.

KË QENË FASHIST

Ndonse unë s'e kam vu asnjiherë distintiven fashiste dhe kam refuzue për me u betue në partì,shum kushtue mos i kuptue idét e mija të vërteta, më kanë mbajtë për fashist.Por,në realitet,kjo s'asht e vërtetë.Idét e mija politike janë për demokraci,pse çmoj thellësisht dobìn e liris së mendimeve.Vetëm,për Shqipnì,tue pa se edhe populli i jonë asht nën influencen patriarkale,feudale e fetare,kam mendue që prej kohe organizimin e intelegjencës shqiptare për me i imponue vendit nocionin e shtetit e me mprojtë me efikacitet të drejtat e popullit.

Përsëris,e kuptoi pa drejtësin e qenjës së nji partije të vetme,por, në nji vend si ky i joni,ku mungojnë edhe udhat,urat e buka e gojës së shumicës së popullit,shum partìna bajnë vetëm rjalë e dame.Veçanrisht,kur nji popull asht mbrapa edhe në pikpamjen kulturale,veprimet e shum partinave politike e hutojnë tue i a prishë karakterin e moralin e tij.Me rjalë të tjera unë kam qenë e jam me mendimet e Nacional Çlirimtarës.


JE ANTIKOMUNIST

Edhe kjo s'asht e vërtetë.Komunist nuk jam,por dhe antikomunist jo; dhe prova asht se,tue pasë mundësina,unë kurr nuk e kam damtue ose përbuzë

AIDSSH

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #9



- 9 -

ndonji komunist.Bile dhe i kam favorizue e ndihmue në rasa të ndryshme dhe për këtë mund të ju jap disa prova.

Unë,komunizmin nuk e kam quejtë kurr të damshëm për popujt e vegjël. Bile,komunizmin e konsideroj nji aletate natyrale të nacionalizmës së popujve të vegjël të kërcënuem të gjithë nga imperializma e fuqive të mëdha.

Këtë e kam kuptue qysh me kohë,por,unë tue kuptue edhe se nën flamurin e komunizmës nuk mund t'a shtinte fuqin e shtetit në dorë,jam çiaqë gjithmonë kundra sajë tue pranue disa principe t'anës së djathtë.Dhe,në qoftë se kam ekzagjerue ndonji herë me ndonji frazë kundra komunizmës kjo ka ardhë e para se kam dashtë të mbesë në terenin nacjonal dhe e dyta se për idét e mija në favor të nji konfederacjoni ballkanik,auktoritetet shqiptare,italjane e gjermane më kanë konsiderue si komunist.Këtë mund të ja u vërtetoj edhe me nji dokument që kam pasë nanë italjanve e të cilin e keni ndër letrat që më keni marrë.Këtë dokument m'a ka dorëzue nji mik i jem Ahmet Kola prej Mati që e kish gjetë në Durrel kur hiken italjanët.Deri Fiqri Dinua kur i kërkova leje dhe përkrahje për me e shpallë partìn t'eme,më tha:"Dhe ti Beqir nuk je tjetër veçse motër e vila me komunizmin".

x x x

PSE KAM KRYESUE FUQINAT VULLNETARE NË KOHEN E ITALIS


Në kohën e okupacjonit italjan dhe unë për dy herë rresnte kam rekrutue fuqina vullnetare në krahinen e Matës.Për të parën herë pata mbledhë 100 veta kur i u deklarue luftë Jugosllavis dhe për të dytën herë në kohën e Mustafa Krujës pak grupue 300 veta për me mbajtë qetësin e Matës.

Për herën e parë e pata mbajtë fuqìn vetëm dy muej dhe për të dyten herë vetëm nji muej e gjysë.Pohoj edhe se,detyrën për me kryesue fuqina e pata kërkue unë vetë dhe nuk më që imponue.Dhe arsyeja e kësaj kërkese asht kjo:tue qenë se unë,tue ndejt 15 vjetë rrjeshtë jashta Atdheut isha ba tepër i huej për Shqipnì e tue çmue se nji ditë do të më duhesh me organizue forca për me luftue me armë okupatorin,me at mënyrë kam dashtë të bij në kontakt me malësorët që nesër,në kohën e dunun të mujsha me dijt me i drejtue për çlirimin e vendit.

AIDSSH

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #10



- 10 -

Që unë kam me due vetëm kështu provohet nga fakti se në kohën që kam kryesue forca s'asht ba ndonji veprim kundra kuejt.Bile,përkundrazi,me cilësin e komandantit kam sjellë vetëm lehtësina popullit.Për tregim tue qenë komandant që kisha për detyrë vetëm për të ndjekë e për të kap t'arratisun,n'emnin e vullnetarve të Matit,i kam drejtue Jacomonit nji telegram tue i kërkue faljen e katër djelmëvet katundarë që i kish kapë forca e gjandarmeris së krues e që i kishte denue me vdekje.Këta djelm isnin kapë nga nji përpjekje që pat Abaz Kupi me fuqit qeveritare të Krujes.Teksti i këtij telegrami mund të ndodhet edhe sot në postën e Krujes.

Njiherë tjeter,kam refuzue me rrethue Abaz Kupin që ndodhej me 20% veta në nji shtëpi të katundit Bruc e unë ndodhesha me 300 veta në Burel.

Prap,pse unë me cilësin e komandantit e kam pasë marrë nën mproje shokun t'uej të shkretin Muhamet Gjollesnin i cili ka pasë qindrue në Burel si shef i zyrës botore, ~~dhe kështu~~ ay ka pasë muejtë me zhvillue pa pengime propaganden e tij Nacional Çlirimtare.Propaganden dhe veprimet e Muhamet Gjolleshit - akuzue si komunist - qeverija e Burelit i ka pasë dijtë në hollësina e mos të isha unë komandent,M/Prefekti i Matës Haruz Hasa do t'a kish kapë Muhametin me të gjithë shokët e tij.

SI PËRFUNDOI FUQIJA E JEME

Tue konstatue se ishte nji punë tepër e vështirë për me drejtue malësorët,e tue kuptue se Mustafa Kruja seriozisht kishte vendosë për me luftue kundrështarët e regjimit,e që për këtë punë donte me i përdorë edhe fuqit e mija,unë dhash dorëheqjen.


Zotnij Gjykatës,me gjithë se unë kam pasë qellime të nalta për me mbaj të forca në kambë,nuk mund të pranojsha për me ba veprime gjakësore kundra popullit.Që unë jam nji natyrë bujare mund të pyetni popullin e Matit ku, as kundërshtarët e mij që më kanë ba aq dame në kohen e Zogut nuk i kam prekë dhe përkundrazi i kam ndihmue në rasa të ndryshme.

Mbassi dhash dorëheqjen si komandant i fuqive vullnetare u emnova si deputet.Dhe këtë barrë të rëndë e pranova jo pse më pëlqente por vetëm e vetëm për mos me u çfaqë si kundërshtarë,por edhe me anën e kësaj detyre të ré s'kam lanë ndërhyrje pa ba për me shpëtue njenin e tjetrin prej burgu e për me lehtësue nevojat e popullit përgjithësisht.

x x x

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #11



- 12 -

shkue në Kosovë tue hjekë njimij mundime për mbledhjen e ngarkimin e groshës ndër vagona.

Në doni me dijtë edhe personat me të cilët e kam ba punën e nda fitimin e lejes,që po ja u tregoj:fitimin e 750 Kv.i a kam dhanë tregtarit Pjetër Pistullit për me m'a drejtue tregtin përgjithësisht pse unë nuk marrë vesht nga tregëtija; fitimin e 500 Kv.i a kam dhanë nji tregtari italjan Pasquale Casero për me më ndihmue që Roma mos të më qitte pengime mbassi siç e thash,Ministrija e Ekonomis Italjane donte që prodhimet t'ona të çonesnin vetëm n'Itali mbassi ajo na i siilte sendet e tjera në Shqipni.Pjesatërët e tjerë janë tregtarët: Filip Korra,Kambi Fundo,Petraq Katro dhe Telo Kondili të cilët kanë derdhë kapitalet për blemjen e groshës dhe shpenzimet e transportit dhe t'importit të mallit.

Këtë lejen e groshës pra e kam fitue me të vertetë me mundë e me mjeshtri sa që të gjithë janë çuditë për suksesin që pata.Përdorimi i kësaj leje ka qenë kaq i vështirë sa që kur deshta njiherë t'i a shes tregtarit Jonuz Shijakut nuk m'orroj ma tepër se (1000) napoljona mbassi paraqitte nji mund e nji rrezik të madh në transporte.

Tash më duhet të ju njoftojë edhe se pjesën e fitimit t'em nuk e kam pasë vetëm për vedi.Kam pasë e kam mbi supa plot njerëz për të mbajtë.Kam nji ndjerkë plakë,kam dy nipa e nji mesë për të martue,kam nji motër me katër fëmij të cilën burri i saj nuk e shikon;kam për të mbajtë gruen t'eme me dy fëmij që më ka mbetë në Paris;tue pasë frikë partizanet e Zogut m'asht dashtë me mbajtë gjithnji katër pesë veta t'armatosun;tue qenë unë në Mat me shum akraballeqe e miqësina m'asht dashtë me çue vazhdimisht ushqime e shtresa.Shtëpija e jeme në Mat ka pritë e përcjellë edhe partizan.


Me gjithë këto obligime familjare s'kam lanë dhe shokë, miqë e akraba pa ndihmue.Dikuej ma shum e dikuej ma pak të gjithve u kam ardhë në ndihmë.E pse kam veprue në këtë mënyrë s'kam muejtë me ba as nji shtëpi të vogël për veten t'eme për me muejt me prue gruen me fëmij.

Kam edhe ma për të tregue: tue qenë se unë nuk jam njeri i dhanun mbas paras e jam mësue gjithnji me përqafue ideale,deklaroj se të tana shpenzimet që janë ba veprimet e grupit të Partis NACJONAL-BALLKANIKE shqiptare i kam ba unë vetë me fondet e mija.

x x x

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #12



- 13 -

121

POZITA E JEME NËN OKUPACJONIN GJERMAN

Ndonse ushtrija gjermane për veprimet e kohës së fundit m'asht ndye keqas,tue dashtë me rolë të drejten,unë Gjermanin nuk e kam pa me sy okupatori.Mbas mendimit t'em ajo kish ardhë në Shqipnì vetëm e vetëm për arsyena strategjije dhe do të largohej posa që të mbaronte lufta.Pëhoj edhe se,ndonse në mëshertësìn e shpirtit t'em nuk më ka pëlqye kurr që nji popull të sundojë mbi të tjerë,kam pasë urue fitimin e gjermanìs,për sigurimin e avenirit të Shqipnis.Me fitimin e gjermanis kam qenë i sigurt për nji Shqipnì të lirë e të pa-coptueme,kurse me fitimin e Aleatve,jo. Dhe këtë besim nuk duhet të m'a queni për faj.

Siç e thash,unë s'kam besim se shtetet e mëdhaja po lufotjnë për parime demokratike e drejtësi,e mandej, s'kanë kalue endé 30 vjetë që në konferencat e Londrës e të Versaille-s,ku Aleatet,për interesat e tyne hegjemonije e sakatuen Shqipnìn në mënyren ma të pa drejtë.

Kështu pra tue e pa Gjermanìn me sy të mirë,kam rolë e shkrue në favor dhe,në periudhen e saj në Shqipni kam pasë pranue me u zgjedhë deputet.Por,prap puna e jeme s'ka qenë tjetër veçse me intervenue pranë auktoriteteve shqiptare e gjermane për njenin e tjetrin.Në mes kaq vetave që kam muejt me shpëtue edhe mue më detyrohet falja e përgjithëshme që u ba ~~fajtorave përgjithshme~~ ku u liruen qindra të burgosun të Nacjonal Çlirimtarës

PSE PRANOVA BARREN E KOMISARIT TË NALTË TË FUQIVE T'ARMATOSUNA


Më duket se asht e pa vend të gjykohem unë për këtë çeshtje.Kur hynë në Tiranë Fuqìt e Nacjonal Çlirimtarës,mue më gjeten si kryetar të nji grupi politik që ka afrim me Nacjonal Çlirimtaren e jo Komisar të Naltë të Fuqive t'Armatosuna.Si Komisar unë nuk qindrova as nji javë për me zhvillue ndonji aktivitet.Me gjithë këte,që po spjegohem edhe për pranimin e kësaj detyre:

Zotnìj Gjykatës,tri qellime më banë që të pranojsha detyrën e Komisarit të naltë dhe këto janë:

1) Tue pa se qeverija e Ibrahim Biçakut ishte tepër e butë me i u imponue Gjermanvet për me i ndalue ata për me ndërhy ndër çeshtjet t'ona, mendova se tue u vu unë "gjermanofil" në krye të fuqive t'armatosuna do të muejsha me e shpëtue vendin nga damet e ndryshme.Tue u bazue mbi neutralitetin e shtetit t'onë të cilin e kishte njoftë Berlini,kam pasë

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #13



- 14 -

122

mendue me ndalue arrestimet e gestapos,me rikthye në Tiranë t'internuemit e Prishtinës si edhe me marrë disa masa që me hikjen e gjermanvet mos të digjej qyteti e mos të na prisheshin urat.Këto që them munde të vertetohet prej urdhnit me shkrim që i kam dhanë komandantit të mbrojtjës kombëtare Gjeneralit Mirdash.Letren munde t'a gjeni në Komandë e me sa mbaj mend përmban tekstualisht këtë:"Indipendenca dhe neutraliteti i shtetit shqiptar dita me ditë po violohet.Ushtrija gjermane ka rilìue me kontrolìue shtëpija e me kap njerëz.Nuk asht çudi që ma vonë të kapen e të pushkatohen njerëz me shumicë si edhe të shorìm djegëjen e qytetit.Për me ndalue pra këto duhet t'organizojmë sa ma parë nji fuqì për me e marrë na vet rojen e qytetit.Dhe për deri sa të mërrijmë me pasë fuqìn e duhun,urdhnoj që të gjithë oficerat dhe nënoficerat t'inkuadrohet e të grupohen në nji kazermë..."


2) Tue mendue se me hikjen e gjermanëve,partìt politike,Nacjonal Çlirimtarja,Balli e Legaliteti do të përleshenìn njena me tjetren për posedimin e fuqìs,me fuqìt qeveritare kam pasë mendue me evitue nji vllá-vrasje tue i detyrue partìt për me i u shtrue zgjedhjeve të nji asambleje të ré ku të gjithë populli të zgjidhte regjimin që don.

3) Tue pa se të tri partìt paraqitshin forca t'armatosuna desha me përfitue edhe unë nga pozita e jeme për me armatosë disa elementa që mund të lidheshin me grupin t'em politik,Partija Nacjonal-Ballkanike Shqiptare. Për këtë qellim të tretë,që qé armatimi i vullnetarve që do të rekrutoja për partìn t'eme,kisha vendosë edhe:në qoftë se s'do të muejsha me luejt rolin qeveritar tue i u imponue partive që t'i u shtroheshin nji zgjedhje të rregullt,do të hidhesha edhe unë me fuqìt e grupit t'em me partìn që kisha ma afrim.Me kohen e pakët që kisha përpapa meje,shpresën ma të madhe e pata vu në realizimin e kësaj pikës së fundit,por dhe kjo s'më doli mbassi Mehdi Bej Frashëri i shtrenguem prej grupit zogist me detyroj me dhanë dorëheqjen.

Më duhet të ju them edhe se,partija me të cilën medoja unë me u lidhë, ishte Nacjonal Çlirimtarja dhe kjo provohet me letrën që i kam drejtue Gjeneralit Dali Ndreu,në të cilën i thonja:Unë kryesoj nji grup të vogël nën emnin Partija Nacjonal Ballkanike Shqiptare me programin që po ju dergoj. Tue mos dashtë me ba çeshtje të përbashkët me Legalitetin e me Ballin që asht lidhë me te,unë,po mbetem këtu.Letrën e pata çue me anën e partizanit Xhemal Meçe dhe tue mos marrë ndonji përgjigje kjesh largue nga Tirana për

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

MEDIA FAQE #14



- 15 -

nja dy javë deri sa u qetësue gjendja.Shenoj edhe se kur e pata dergue këtë letër, ruqit e Ballit nuk qenë shkatrrue endé as në Durrës,as në Shkodër.

Tash,Zotnij Gjykatës,në qoftë se do të çmoni shpirtin e qellimet e mija e faktin se efektivisht s'kam sjellë kurrnji dam vendit e levizjës s'uej, unë jam i sigurt se mue do të më nxierrni krejt të parajshëm.Por,prap vetëm fakti në vetvedi që unë po ~~të~~ gjykohem përpara jush më randon përsëtepërmi. Unë djalë populli e natyrë luftarake,me qellimet që kam pasë s'kam qenë për me mërrijtë këtu.Unë që edhe kur isha fëmi jam përpjekë e sakrifikue për nji ideal kombëtar e antifeudal tue pësue disa burgime,internime,ekspulsime, tortura e që kam pa edhe mbarimin tragjik të familjës s'ime,unë nuk duhesh të gjykohesha para jush,Nacjonal Çlirimtarë,pse më mëshertësin e zemrës s'emë më pëlqen dhe aprovojë që okupatori dunet luftue me çdo kusht.

(Bekir Walter)

5 - 2 - 1945

AIDSSH

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

INFORMACION

Mbrojtja e Beqir Valterit drejtuar trupit gjykues të Frontit Nacional Çlirimtar

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.